

Instituti Albanologjik, Prishtinë

Dega e Folklorit

26.02.2026

INSTITUTI ALBANOLOGJIK PRISTINE			
Data: 27.02.2026			
1	2	3	4
IAP	34		

REFERAT

i Komisionit vlerësues për përzgjedhjen e kandidatit/es për pozitën

Bashkëpunëtor shkencor në Degën e Folklorit

Komisioni vlerësues, i miratuar në mbledhjen e Këshillit shkencor të Institutit Albanologjik, të mbajtur më 12.02.2026, në mbështetje të *Statutit të Institutit Albanologjik dhe Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punënonjësve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin Albanologjik*, ka vepruar në kuadër të kompetencave të përcaktuara me Rregullore, duke zbatuar parimet e: ligjshmërisë, barazisë së trajtimit, transparencës, meritës dhe profesionalizmit e proporcionalitetit në vlerësim.

Të dhënat mbi konkursin dhe kandidatët

Konkursi publik i shpallur më datë 15.01. 2026 në web-faqen e Institutit Albanologjik, për pozitën:

- **Bashkëpunëtor shkencor në Degën e Folklorit.**

Në konkurs kanë aplikuar dy kandidate:

1. **Ylberza Halili**, doktor i shkencave filologjike - titull i mbrojtur në Fakultetin e Filologjisë, Universiteti i Prishtinës, me formim dhe përvojë shumëvjeçare në fushën e folkloristikës dhe angazhim mbi dhjetë (10) vjet në Degën e Folklorit në Institutin Albanologjik

2. **Kristina Palokaj – Përkola**, doktor i filozofisë në shkenca humane, fusha shkencore e arteve - titull i mbrojtur në Fakultetin e shkencave humane dhe sociale, Universiteti i Zagrebit (Kroaci), me përvojë në fushën e muzikologjisë

Përgatitja profesionale e kandidateve që kanë konkurruar

Bazuar në kushtet e Konkursit, ku përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, kandidatët duhet t'i plotësojnë edhe kushtet e veçanta të përcaktuara me *Ligjin e Veprimtarisë Kërkimore-Shkencore, nr.04/L-135; Statutin e Institutit Albanologjik dhe Rregulloren për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes së Punonjësve Shkencorë dhe Hulumtuesve në Institutin Albanologjik*, Komisioni i ka shqyrtuar dokumentacionet e dorëzuara nga kandidatet dhe arsyeton si në vijim:

Kandidatja **Ylberza Halili**, (e lindur më 14.11.1984 në Prishtinë)

Arsimimi

- ka diplomën e titullit *Doktor i shkencave filologjike*, të mbrojtur në Universitetin e Prishtinës. Tema e doktoraturës “ Intertekstualiteti në përrallat e Donat Kurtit”
- ka diplomën e titullit *Master i shkencave filologjike*, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë.
- Ka diplomën e titullit *Bachelor i Letërsisë shqipe*, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë.
- Ka diplomën e titullit *Bachelor i Gjuhës dhe letërsisë angleze*, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë.

Publikimet

- ka të botuar një monografi shkencore me titull “*Grafitet në folklor*”, botim i Institutit Albanologjik;
- ka të botuar punime në:

1. Revista relevante kombëtare dhe ndërkombëtare:

- *Gjurmime albanologjike, Folklor dhe Etnologji* – 3 punime dhe 3 recensione
- *Seminari XXXVndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare dhe ndërkombëtare* – 1 punim
- *Albanologji* – revista e aktivitetit “Java e Albanologjisë” – 8 punime
- *Ballkanologjia* – revista shkencore e Institutit të Trashëgimisë kulturore të shqiptarëve në Shkup - (1 punim)
- *Shejzat* – revistë shkencore kulturore letrare e antropologjike (SCOPUS) – 1 punim

2. Akte konferencash:

- *“Parallel worlds in Ballad and Folk Songs”* - konferenca ndërkombëtare e baladës, Kommission fur Volksdichtund dhe Instituti Albanologjik, - 1 punim
 - *“Sociocultural dimensions of childhood”* - konferencë ndërkombëtare, Akademia e shkencave bullgare, Sofje – 1 punim
 - *“Figura me vlera shkencore dhe kulturore shqiptare nga Lugina e Preshevës dhe vise të tjera shqiptare”*, - Shoqata shqiptare, Preshëevë - 1 punim
- Tema e doktoraturës së kandidatës Ylberza Halili, me titull “ Intertekstualiteti në përrallat e Donat Kurtit”, dëshmon rëndësinë e folklorit si burim themelor i letërsisë, duke treguar se si motivet, figurat dhe strukturat tradicionale ndërthuren me forma të shkruara artistike. Aty folklorit trajtohet nga aspekti filologjik e letrar.
 - Si në studimin monografik të Ylberza Halilit mbi *Grafitet* si shprehje të folklorit urban ashtu edhe në artikujt e botuar mbi studimet mbi përrallat e Donat Kurtit, konstatohet një lidhje thelbësore mes folklorit dhe letërsisë, ku motivet dhe simbolet popullore shërbejnë si ura që lidhin praktikën e përditshme kulturore me interpretimin letrar dhe artistik.

Përvoja

- Kandidatja Ylberza Halili ka mbi 10 vjet përvojë pune pikërisht në Degën e Folklorit në Institutin Albanologjik në Prishtinë, me njohje të arkivit, projekteve kërkimore dhe praktikës së punës në terren.

- Nga viti 2013 – 2024 kur ka punuar në këtë Degë ka treguar përkushtim në punë, profesionalizëm dhe korrektësi duke qenë e përgjegjshme për të gjitha detyrat që ia ka dhënë Dega dhe që ia ka lejuar etika e punës.
- Ka mbi 15 certifikata pjesëmarrjeje në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, 5 sosh janë ndërkombëtare, përfshirë një pjesëmarrje në shkollë verore për antropologji dhe folklor në Konicë të Greqisë..

Kandidatja **Kristina Palokaj**, (e lindur më 21.09.1986 në Prishtinë).

Arsimimi

- ka gradën *Doktor i filozofisë në shkenca humane - fusha shkencore e arteve*, të mbrojtur në Universitetin e Zagrebit (Kroaci). Tema e doktoratës: “Histori of Art Music and Musicology in Kosovo from 1945 to 2020” (shqip: Historia e artit muzikor dhe e muzikologjisë në Kosovë nga 1945 – 2020).
- Ka diplomën e titullit *Master i pedagogjisë së muzikës*, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Arteve
- Ka diplomën e titullit *Bachelor* në dy drejtime *muzikologji dhe pedagogji e përgjithshme muzikore*, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Arteve.
- Ka 3 certifikata të njohjes së gjuhës angleze dhe gjermane, të lëshuara nga kurset në Prishtinë
- Ka indeksin e metrikës së publikimeve të saj, nga Web of Science

Publikimet

- ka të botuar katër monografi (shkencore, historike e institucionale) dhe një libër didaktik, si më poshtë:

1. *The Outlines of a Social History of Music in Kosovo (1945 – 2020)*, botim i Croatian Musicology Society (HDM)¹, Zagreb, 2025.
 2. *Shkolla e muzikës Prenk Jakova 1949 – 2024* (bashkautore me Violeta Krasniqi), SHB “Jakup Ceraja”, Prishtinë, 2025.
 3. *Skena Muzikore e Prishtinës – Festivali i parë i muzikës klasike në Kosovë (1974 – 1988), 50 vjetori i themelimit*, SHB “Jakup Ceraja”, Prishtinë, 2024.
 4. *Dy jetë për muzikë – Rexho Mulliqi dhe Nexhmije Pagarusha*, SHB “Jakup Ceraja”, Prishtinë, 2023.
 5. *Solfegio fillestare* (bashkautore me Violeta Krasniqi), libër shkollor, Artini, Prishtinë, 2022.
- ka të botuar në revista kombëtare e ndërkombëtare:
23 artikuj shkencorë nga fusha e muzikologjisë shqiptare, prej tyre 8 në revista ndërkombëtare, përfshirë 5 sosh të publikuara edhe në platformën SCOPUS:
 - *Musicologist* – 1 punim;
 - *Rast musicology journal* – 1 punim;
 - *International Review of the Aesthetic and Sociology of Music* – 1 punim
 - *Knowledge International Journal; Modern Music* – 1 punim;
 - *Digital Production and management* – 1 punim;
 - *Gjurmime Albanologjike*, seria folklor dhe etnologji – 1 punim;
 - *Studime shoqërore* – ASHAK - 1 punim;
 - *Albanologji* (Java e Albanologjisë) – 2 punime;
 - Universiteti UBT – 7 punime;
 - Akte konferencash – 4 punime
 - si dhe artikuj shkencorë e publicistikë në gazeta e periodikë në Prishtinë, Shkup e Tiranë.

¹ HDM - Hrvatsko muzikološko društvo është Shoqata kroate e muzikologjisë (Croatian Musicological Society), gjegjësisht institucioni kryesor profesional në Kroaci për studiuesit e muzikës. Është organizatë shkencore dhe profesionale në Kroaci që merret me studimin dhe kërkimin e muzikologjisë (historia e muzikës, teoria e muzikës, etnomuzikologjia, etj.), organizon konferenca, simpoziume dhe aktivitete shkencore; publikon revista dhe punime shkencore në fushën e muzikologjisë; promovon studimin e trashëgimisë muzikore kroate. <https://hmd-music.org/>

- Libri *The Outlines of a Social History of Music in Kosovo (1945 – 2020)* i autores Kristina Palokaj Perkola është një monografi shkencore dhe historiografike që paraqet rrugëtimin e muzikës në Kosovë gjatë periudhës 1945-2020. Ai nuk është vetëm një kronikë e ngjarjeve muzikore, por një analizë sociale dhe historike e zhvillimit të jetës muzikore në këtë territor gjatë rreth 75 vjetëve të fundit. I pasur me dokumente e dëshmi libri është një histori sociale e muzikës në Kosovë, që përshkruan se si është zhvilluar kultura muzikore gjatë periudhës 1945–2020.

Përvoja

- ka kontratë angazhimi në projektin e ASHAK: *Fjalori enciklopedik i Kosovës*; angazhime në projektin *Enciklopedia shqiptare*;, ashtu si edhe dëshmi për angazhime në organizime koncertesh;
- ka kontrata pune me Kolegjin UBT, Shkollën e muzikës “Prenk Jakova”, Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë.
- ka certifikata arritjesh në fushën e pedagogjisë muzikore si edhe pjesëmarrjesh në konferenca e tryeza nga fusha profesionale, kombëtare e ndërkombëtare.

Aktualisht punon si profesoreshe e rregullt në shkollën e mesme të lartë të muzikës “Prenk Jakova” në Prishtinë dhe si profesoreshe e angazhuar në Kolegjin UBT në Prishtinë.

Kandidatja Kristina Palokaj nuk ka dëshmi të mjaftueshme profesionale e institucionale në fushën e folkloristikës.

Çështja e interpretimit të profilit të kërkuar

Në tekstin e konkursit nuk është cekur formulimi eksplisit për profil në folkloristikë, por pozita është shpallur qartazi në kuadër të Degës së Folklorit, si njësi organizative me kompetencë dhe fushëveprim të përcaktuar.

Komisioni ka shqyrtuar me kujdes faktin që konkursi nuk e ka specifikuar shprehimisht “profilin folkloristik” megjithatë, në interpretim sistematik dhe në bazë të qëllimit të shpalljes së konkursit:

- Pozita është e lidhur funksionalisht me Degën e Folklorit;
- Veprimtaria shkencore e kësaj dege është e përcaktuar në aktet themeluese dhe dokumentet programore të institucionit;
- Qëllimi i shpalljes së pozitës ka qenë përmbushja e nevojave kërkimore në fushën e folkloristikës.
- Në rast të nevojës për profil specifik, me përgatitje tjetër nga ai i folkloristit, kjo kërkesë do të specifikohet në konkurs, duke u vënë theksi në sektorin e veçantë të Degës së Folklorit, siç është sektori i Etnomuzikologjisë. Mungesa e specifikimit të kërkesës për etnomuzikolog, në konkurs, e arsyeton se nuk kërkohet ky profil.

Sipas praktikës së administrimit akademik dhe parimit të interpretimit sipas qëllimit të normës, kur një pozitë shpallet në kuadër të një njësie të specializuar, kërkohet përputhshmëri substanciale me fushën e asaj njësie, edhe nëse kjo nuk është artikuluar me terminologji eksplicite në tekstin e konkursit.

Në këtë kuptim, Komisioni ka vlerësuar jo vetëm diplomat për arritjet e kandidateve krahas veprave dhe punimeve të botuara, por edhe përputhshmërinë reale dhe funksionale të profilin profesional të kandidateve me veprimtarinë e Degës.

- Kandidatja, Ylberza Halili, ka përgatitje akademike dhe përvojë në fushën e folkloristikës;
- Kandidatja, Kristina Palokaj, ka përgatitje akademike dhe përvojë në fushën e muzikologjisë.

Komisioni vlerëson se Dega e Folklorit në Institutin Albanologjik, në themel të konceptimit të saj e ka *Letërsinë popullore*, përderisa *Etnomuzikologjia* është sektor plotësues në profilin akademik të Degës. Në këtë kontekst, në planin kuadrovik numri i punonjësve shkencorë nga fusha e Etnomuzikologjisë (me përgatitje akademike muzikologjike ose etnomuzikologjike) asnjëherë nuk e ka tejkaluar masën 1/3 në raport me kuadrin e përgjithshëm të të punësuarve. Boshti qendror i konceptit të Degës së Folklorit, ka qenë dhe është folklori, respektivisht qasja filologjike ndaj folklorit dhe prandaj shumica e numrit të të punësuarve gjithmonë kanë qenë folkloristë (me

përgatitje akademike filologjike (albanologji)), në raport 2/3 (ose më shumë) me numrin e përgjithshëm të të punësuarve në Degën e Folklorit.

Në gjendjen aktuale, raporti i folkloristëve me etnomuzikologë është 4 me 3, pra katër folkloristë dhe tre etnomuzikologë. Dega e Folklorit aktualisht ka mungesë të profilit folkloristik, prandaj e ka shumë të nevojshme plotësimin e këtij profili.

Përputhshmëria me nevojat funksionale të njësisë

Komisioni, në procesin e vlerësimit e ka pasë parasysh Statutin e Institutit Albanologjik, neni 2, ku përshkruhet Veprimtaria e Institutit Albanologjik, dhe pikat: pikat 4.4 dhe 4.5, ku shkruan se në këtë fushëveprimtari hyn

- *studimi i folklorit dhe i kulturës popullore shqiptare në tërësinë e saj;*
- *si dhe studimi i etnomuzikologjisë dhe të muzikologjisë shqiptare.*

Bazuar në këto pika përgatitja profesionale e kandidatës nga muzikologjia nuk është jashtë sferës së veprimtarisë së Degës së Folklorit dhe në një rast tjetër mund të jetë nevojë dhe kërkesë e paraparë me konkurs, por kësaj radhe nevoja e Degës së Folklorit është për një kuadër të përgatitur në fushën e folkloristikës. Prandaj, Komisioni ka marrë parasysh nevojën për:

- vazhdimësi në projektet ekzistuese kërkimore;
- njohje të fondit arkivor të folklorit;
- përvojë në hulumtime në terren në fushën e folkloristikës;
- integrim të menjëhershëm në veprimtarinë shkencore të Degës.

Në këtë aspekt, kandidatja me përvojë shumëvjeçare në Degën e Folklorit paraqet përputhshmëri të plotë funksionale dhe operative.

Parimi i meritës dhe proporcionalitetit

Komisioni ka respektuar parimin e meritës, duke bërë vlerësim krahasues dhe jo përjashtues. Të dyja kandidatet janë vlerësuar si të kualifikuara në aspektin e përgatitjes akademike.

Megjithatë, në një proces konkurrues, përzgjedhja bazohet në përputhshmërinë më të lartë me pozitën konkrete, jo vetëm në nivelin e përgjithshëm të arritjeve akademike.

Diferenca vendimtare në këtë rast qëndron në:

- përvojën specifike dhe të drejtpërdrejtë në Degën e Folklorit;
- kontributin e dëshmuar në fushën e folkloristikës;
- përputhshmërinë funksionale me qëllimin e shpalljes së pozitës.

Përfundimi dhe rekomandimi

Pas shqyrtimit të plotë të dokumentacionit, analizës krahasuese dhe zbatimit të kriterëve të rregullores, Komisioni konstaton se:

Kandidatja **Ylberza Halili** paraqet përputhshmëri më të lartë profesionale, funksionale dhe institucionale me pozitën **Bashkëpunëtor shkencor në Degën e Folklorit**.

Për rrjedhojë, Komisioni i propozon organit Këshillit shkencor të Instituti Albanologjik miratimin e përzgjedhjes së saj për këtë pozitë.

Ky rekomandim bazohet në analizë objektive, krahasuese dhe në zbatim të plotë të Rregullores dhe Statutit të Institutit Albanologjik.

Komisioni në përbërje:

26.02.2026

Dr. Arbnora Dushi, këshilltare shkencore

A. Dushi

Dr. Leontina Gega Musa, këshilltare shkencore

L. G. Musa

Dr. Albin Sadiku, këshilltare shkencore

A. Sadiku